

Mbledhja e VII. e Përgjithshme

19.03.2017

Shoqata Rainca

www.shoqata-rainca.ch




Agjenda

- Aktivitet e kryesisë 2016
- Raporti Financiar 2016
- Pyetje
- Votimi i Statusit të Shoqatës – Version II

Aktivitetet e kryesisë 2016

- Takimet e kryesisë në vendet e ndryshme te Zvicrës



Aktivitetet e kryesisë 2016

- Turneu Tradicional në Raincë



Aktivitetet e kryesisë 2016

- Takimi Familjar i Raincës ne Zvicër



Shoqata Rainca
www.shoqata-rainca.ch



Shoqata Rainca Takimi 2016

Të nderuar Raincali, jeni të ftuar që të merrni pjesë në manifestimin tradicional organizuar nga Shoqata Rainca.
Hyrja Fr. 20.- / 10.- për fëmijë 10-16 vite / Gratis për fëmijë nën moshë 10 vite
Mos harroni t'i ftoni të gjithë Raincalit!

Data: 12.11.2016
Orari: nga 17.00
Adresa:
Les Epicéas 7
1563 Dompierre

Ju lutemi që të lajmroni pjesëmarrjen tuaj në këta numra deri më datë 31.10.2016

Bujar Sulimani Kryetar
076 579 41 42
Arben Ramadani Arkatar
078 664 13 44
Faton Jusufi
076 327 92 57



Ju argëton Labinot Rexha

www.shoqata-rainca.ch
info@shoqata-rainca.ch

Shoqata RAINCA

Aktivitetet e kryesisë 2016


- Uebfaqja e re e shoqatës e ndërtuar në 2016



Aktivitete e kryesisë 2016

Idea e uebfaqes së re dhe shërbimet

- Lista aktuale te anëtarve (aktualizimi çdo 30 ditë)
- Fotografi nga Rainca
- Kontakti përmes emailit
- Anëtarësimi online
- Porosia e fletpagesave
- Statuti i II 2017 (propozim)
- Reklamë për afarist në uebfaqe (Fr. 150 për një vit)
- Lista e afaristëve të Raincës



Aktivitete e kryesisë 2016

Lista e afaristëve të Raincës

Idea: ti regjistrojmë të gjitha shërbimet dhe afarsitët e Raincës në uebfaqe, që në cdo rast ta investojë paren ne Raincë.




Aktivitetet e kryesisë 2016


- Uebfaqja e re e shoqatës e ndërtuar në 2016



Raporti Financiarë 2016 / Statistik




Raporti Financiarë 2016 / Statistik



Raporti Financiarë 2016 / Statistik

Antarë si mbas kantonit ne %



AG
AR
BE
FR
GE
GL
GR
SG
SO
TG
VD
VS
ZH
BL

Raporti Financiarë 2016 / Statistik

I. Të hyrat

Përshkrimi	Shuma ne CHF
Mjetet e bartura nga 2015	5.223,75 CHF
Te hyrat nga anëtarësia 2016	17.308,24 CHF
Te hyrat 2016	22.531,99 CHF

Raporti Financiarë 2016 / Statistik

II. Te dalurat – Përmbledhja e shpenzimeve sipas kategorisë

	Shuma ne CHF
Ndihma humanitare	7.000,- CHF
Sport	650,- CHF
Kulturë	3.780,- CHF
Investime kapitale	3.945,70 CHF
Mirëmbajtja e fshatit	2.000,- CHF
Shpenzime administrative	898,- CHF
II. Te Dalurat 2016	18.273,70 CHF

Raporti Financiarë 2016 / Statistik

II Të dalurat – Përmbledhja e shpenzimeve: ndihma humanitare

Ndihmë financiarë rast vdekje E.S	300,- CHF
Ndihmë financiarë per shërim I.M.	500,- CHF
Ndihmë financiarë rast vdekje H. I	400,- CHF
Ndihmë financiarë- ndërtim Shtepie-A.N.	2.000,- CHF
Ndihmë financiarë për Ramazan-Jetimët në Raincë	1.400,- CHF
Ndihmë financiareë- Shporta Bajramit	800,- CHF
Ndihmë financiarë rast vdekje R.X	500,- CHF
Ndihmë financiarë rast vdekje I. M.	300,- CHF
Ndihmë financiarë familjes Selajdin N. Yi	300,- CHF
Ndihmë financiarë për shkollim-K. F.	500,- CHF
Shuma	7.000,00 CHF

Raporti Financiarë 2016 / Statistik

II Të dalurat – Permbledhja e shpenzimeve: Sport

Ndihmë financiare-Turniri Tradicional	200,- CHF
Ndihmë financiare-Dresat KF Rainces	200,- CHF
Ndihmë financiare-KF Rainca -turniri ne Recak	250,- CHF
Shuma	650,- CHF

Raporti Financiarë 2016 / Statistik



Ndihma për Bajram

Raporti Financiarë 2016 / Statistik

K.F. Rainca



Raporti Financiarë 2016 / Statistik

II Te dalurat – Përmbledhja e shpenzimeve: kulturë

Sala Glarus Bilten (të dalura 2015, pagesa 2016)

480,- CHF

Takimi familjarë Rainca në CH

3.300,- CHF

Shuma

3.780,- CHF

Raporti Financiarë 2016 / Statistik

- Takimi familjarë 2016



Raporti Financiarë 2016 / Statistik

II Të dalurat – Përmbledhja e shpenzimeve: investime kapitale

Rregullimi i rruges-Udhet e kryct	445,70 CHF
Rrethimi i varrezave tek Ambulanca	2.000,- CHF
Rregullimi i kanalizimit / rrugës-Lagja Eshtref Arifi	1.500,- CHF
Shuma	3.945,70 CHF

Raporti Financiarë 2016 / Statistik

- Të dalurat II



Raporti Financiarë 2016 / Statistik

II Të dalurat – Përmbledhja e shpenzimeve: mirëmbajtja e varrezave

Mirëmbajtja e fshatit / varrezave	2.000,- CHF
Shuma	2.000,- CHF

Raporti Financiarë 2016 / Statistik

Përmbledhja e shpenzimeve: mirëmbajtja e varrezave



Raporti Financiarë 2016 / Statistik

II. Të dalurat – përmbledhja e shpenzimeve: shpenzime administrative

Lap Top- Shoqata Rainca	349,- CHF
Pagesa dhe rezervimi i emrit www.shoqata-rainca.ch	100,- CHF
Videobeamer- Shoqata Rainca	449,- CHF
Shuma	898,- CHF

Raporti Financiar 2016 / Statistik

Paraqitja tabelare e shpenzimeve vjetore 2016

Nr.	Bezeichnung/ Pershkrimi	Kategorizimi	shuma ne CHF
1	Rregullimi i Rrugës-Udhet e kryct	Invesitme Kapitale	445,70 CHF
2	Rrethimi i varrezave tek Ambulanta	Investime Kapitale	2.000,- CHF
3	Rregullimi i kanalizimiz / Rrugës-Lagja Eshtref Arifi	Investime Kapitale	1.500,- CHF
4	Sala Glarus Bilten (te dalura 2015, pages 2016)	Kultur	480,- CHF
5	Takimi Familjar Rainca ne CH	Kultur	3.300,- CHF
6	Mirembajtja e Fshatit / Varrezave	Mirembajtja e Fshatit	2.000,- CHF
7	Ndihm Financiare Rast vdektje Evzi Sulimani	Ndihma Humanitare	300,- CHF
8	Ndihm Financiare per sherim (Xhonit)	Ndihma Humanitare	500,- CHF
9	Ndihm Financiare Rast vdektje Hajdar Imeri	Ndihma Humanitare	400,- CHF
10	Ndihm financiare-ndertim Shtepie-Avni Nuki	Ndihma Humanitare	2.000,- CHF
11	Ndihm Financiare per Ramazan-Jetimet ne Raince	Ndihma Humanitare	1.400,- CHF
12	Ndihm Financiare -Shporta Bajram	Ndihma Humanitare	800,- CHF
13	Ndihm Financiare Rast vdektje Ruhan Xhelili	Ndihma Humanitare	500,- CHF
14	Ndihm Financiare Rast vdektje Imran Musliu	Ndihma Humanitare	300,- CHF
15	Ndihm Financiare Familjes Selajdin Nexhib Ymeri	Ndihma Humanitare	300,- CHF
16	Ndihm financiare per shkollim-Kreshnik Fazliu	Ndihma Humanitare	500,- CHF
17	Lap Top -Shoqata Rainca	Shpenzime Administrative	349,- CHF
18	Rezervimi i adreses www.shoqata-rainca.ch	Shpenzime Administrative	100,- CHF
19	Biemer-Shoqata Rainca	Shpenzime Administrative	449,- CHF
20	Ndihm Financiare-Turniri Traditional	Sport	200,- CHF
21	Ndihm Financiare-Dresat KF Rainces	Sport	200,- CHF
22	Ndihm Financiare-KF Rainca -turniri ne Recak	Sport	250, CHF

Totali i Shpenzimeve 2016

18.273,70 CHF

Raporti Financiarë 2016 / Statistik

Bilanci

I. Të hyrat

22.531,99 CHF

II. Të dalurat

18.273,7 CHF

III. Gjendja (I. - II.)

4.258,29 CHF

01.01.2017

Pytje, sygjërime, propozime për Fshatin tonë



Statuti i shoqates Rainca Version II

STATUTI

EMRI DHE SELIA

NENI 1.

Me emrin Shoqata “Rainca” ekziston një shoqatë e pavarur dhe neutral politikisht dhe konfesionalisht sipas Art. 60ffZGB me seli në Zürich.

NENI 2.

Shoqata Rainca ka Logon,Vulën dhe Konton e saj

Statuti i shoqates Rainca Version II

QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E SHOQATËS **NENI 3.**

Shoqata “ Rainca” ka për qëllim:

a) Rritjen e mirëqenies dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në Raincë

(përmes pjesëmarrjes në projekte, financimin apo bashkëfinancimin e tyre).

b) Organizimin e festave, mbledhjeve dhe aktiviteteve humanitare dhe të lira në vendlindje dhe diasporë.

c) Bashkëpunimin me organizatat si motra.

NENI 4.

Shoqata nuk mund të ushtron as aktivitet politik, as të përdor pasurinë dhe mjetet e veta për realizimin e qëllimeve të partive politike.

Statuti i shoqates Rainca Version II

ANËTARËT DHE ANËTARËSIMI

NENI 5.

Secili Person, i cili vjen nga Rainca apo është në ndonjë lidhje të veçantë me Rincën dhe banorët e saj, dhe i cili shpreh dëshirën për anëtarësim mundë të bëhet anëtarë i Shoqatës „ Rainca“.

NENI 6.

Anëtarë bëhet secili që paguan anëtarësinë vjetore.

NENI 7.

Anëtarët paguajnë anëtarësinë vjetore gjatë vitit kalendarik. (koha e pagimit :Janar-Dhjetorë)

NENI 8.

Personi nuk mund të anëtarësohet në shoqatë për qëllime politike apo organizim partiak.

NENI 9.

Anëtari i shoqatës Rainca do të ketë dokumentin e anëtarësimit në shoqatë: librezën e anëtarësisë.

Statuti i shoqates Rainca Version II

TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E ANËTARËVE

NENI 10.

Anëtarët kanë këto të drejta :

- a) të drejtë të zgjedhin edhe të zgjidhen në organet e shoqatës,
- b) të ngrejnë iniciativa dhe të parashtrojnë propozime të caktuara,
- c) të angazhohen në realizimin e detyrave dhe aktiviteteve të parapara në organet e shoqatës.
- d) të jenë të informuar dhe të kenë qasje në informata në çdo moment.

NENI 11.

Anëtarët kanë këto obligime:

- a) Çdo anëtar i nënshtrohet statutit dhe vendimeve të organeve të shoqatës,
- b) merr pjesë në mbledhjet e organeve të shoqatës

(minimum në Mbledhjen Gjenerale) dhe

- c) paguan rregullisht anëtarësimin.

Statuti i shoqates Rainca Version II

TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E ANËTARËVE

NENI 12.

Anëtarësimi përfundon me largimin vullnetar nga shoqata. mundësisht me shkrim dhe në fund të vitit kalendarik.

NENI 13.

Anëtari mundë të përjashtohet nga Shoqata me një vendim të kryesisë dhe i merret dokumenti i anëtarësisë në rast se:

- a) nuk zbaton statutin, ose
- b) nuk i bindet organeve të Shoqatës, ose
- c) vepron kundër interesave të Shoqatës;

Çdo anëtarë ka të drejtë të paraqesë ankesë në mbledhjen e ardhshme gjenerale. Vendimi i organit më të lartë është përfundimtarë.

Statuti i shoqates Rainca Version II

DREJTIMI I SHOQATËS

NENI 14.

ORGANET E SHOQATËS JANË:

- a) Kuvendi i Shoqatës (Mbledhja Gjenerale)
- b) Kryesia e Shoqatës
- c) Këshilli për kontrollë

Statuti i shoqates Rainca Version II

DREJTIMI I SHOQATËS

KUVENDI

NENI 15.

Kuvendi i Shoqatës (Mbledhja Gjenerale) përbën organin më të lartë të Shoqatës.

NENI 16.

Mbledhja Gjenerale e rregullt thirret nga Kryesia e shoqatës

Mbledhja Gjenerale e rregullt mbahet një herë në vit.

Mbledhja Gjenerale e rregullt mbahet në dymuajt e parë të vitit.

NENI 17.

Thirrja e anëtarëve për në Kuvend bëhet nga Kryesia e Shoqatës mundësisht me shkrim (Post), dhe duhet të publikohet në faqen e saj në Facebook (Shoqata Rainca).

Thirrja e anëtarëve për në Kuvend bëhet minimum 6 javë para mbajtjes së mbledhjes.

Statuti i shoqates Rainca Version II

DREJTIMI I SHOQATËS

KUVENDI

NENI 18.

Ftesa për Mbledhje Gjenerale duhet të përmbaj:

- a) Datën e mbajtjes së mbledhjes
- b) Kohën e mbajtjes së mbledhjes
- c) Vendin e mbajtjes së mbledhjes
- d) Agjendën (Pikat e rendit të ditës)
- e) Nënshkrimin e Kryetarit të Shoqatës

NENI 19.

Mbledhja Gjenerale e jashtëzakonshme mundet të thirret nga:

- a) Kryesia e Shoqatës ose
- b) 1/5-ta e numrit të përgjithshëm të Anëtarëve të shoqatës.1

Statuti i shoqates Rainca Version II

DREJTIMI I SHOQATËS

KUVENDI

NENI 20.

Që të thirret mbledhja e jashtëzakonshme sipas pikës b). anëtarët duhet:

- a) të mbledhin nënshkrimet,
- b) të caktojnë rendin e ditës dhe
- c) kërkesën me shkrim t'a deponojnë në Kryesinë e Shoqatës.

Afati për thirrjen e një mbledhje të jashtëzakonshme është tri javë nga vendimi për një mbledhje të tillë.

Statuti i shoqates Rainca Version II

DREJTIMI I SHOQATËS

INGERENCAT E MBLEDHJES GJENERALE (KUVENDIT)

NENI 21.

Mbledhja Gjenerale ka këto ingerenca:

- a) votimi dhe ndryshimi i Statutit
- b) Zgjedhjen dhe shkarkimin e Kryesisë së Shoqatës dhe Këshillin për Kontroll
- c) Pranimin e raportit të Kryesisë së Shoqatës dhe Këshillit për Kontroll
- d) Vendosjen e kontributeve vjetore
- e) Marrjen e vendimeve kur organeve tjera u ndalohet me statut të marrin vendime të caktuara.
- f) Shqyrton kërkesën dhe ankesët e Kryesisë dhe anëtarëve
- g) Shpërbërjen e Shoqatës“ Rainca“

Statuti i shoqates Rainca Version II

NENI 22.

Kuvendi merr vendime kur janë të pranishëm minimum $\frac{1}{5}$ e anëtarëve të Shoqatës.2
Kuvendi merr vendime me shumicën e thjesht të votave të anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje.

NENI 23.

Nëse për marrjen e një vendimi nuk plotësohet NENI 22. atëherë thirret një mbledhje tjetër, e ngarkuar me të njëjtin rend dite, e cila mund të marrë vendime pa u bazuar në numrin e anëtarëve të pranishëm.

NENI 24.

Vendimet e Kuvendit protokollohen dhe nënshkruhen nga kryetari i shoqatës.
Votimi bëhet kryesisht i hapur.
Secili Anëtar ka të drejtë vetëm në një votë.

NENI 25

Votimi I mbyllur (me shkrim) bëhet vetëm nëse kërkohet nga shumica e anëtarëve prezent në mbledhje.

Statuti i shoqates Rainca Version II

KRYESIA E SHOQATËS

NENI 26

Kryesia është organ ekzekutiv i shoqatës “RAINCA”.

NENI 27

Kryesia e Shoqatës përbëhet kryesisht nga 9 anëtarë të saj.

NENI 28.

Kryesia nga anëtarët e saj zgjedhë Kryetarin, Arkatarin dhe Sekretarin e Shoqatës Rainca. Votimi bëhet kryesisht i hapur. Votimi i mbyllur (me shkrim) bëhet vetëm nëse kërkohet nga shumica e anëtarëve të kryesisë.

NENI 29.

Kryesia zgjidhet për një mandat dy vjeçarë me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër.

Statuti i shoqates Rainca Version II

KRYESIA E SHOQATËS

Detyrat dhe Obligimet e Kryesisë së Shoqatës Rainca

NENI 30

Kryesia e shoqatës si detyrë primare ka realizmin e qëllimeve dhe objektivave të shoqatës të parapara me statut.

Detyrat dhe obligimet tjera janë:

- a) ta udhëheqë të gjithë veprimtarinë e shoqatës.
- b) të merr vendime te nevojshme për funksionimin, organizimin dhe administrimin e shoqatës;
- c) të menaxhoj Buxhetin e Shoqatës
- d) të jetë transparent për punën e vet përmes publikimit të raportit tremujorë financiarë dhe një herë në vit në Kuvendin e shoqatës të raportojë për punën dhe aktivitetet e realizuara;
- e) të përfaqësoj shoqatën brenda dhe jashtë.

Statuti i shoqates Rainca Version II

KRYESIA E SHOQATËS

NENI 31

Kryesia jep llogari para Kuvendit.

Humbja e të drejtës si Anëtarë i Kryesisë

NENI 32

Anëtari i Kryesisë që nuk merr pjesë në tri mbledhje radhazi dhe nuk e arsyeton mungesën e vetë përjashtohet nga Kryesia e Shoqatës Rainca.

NENI 33

Nëse 1/3 e anëtarëve të kryesisë për arsye të tyre dorhiqet,apo përjashtohet nga kryesia, kryesia nuk mundë të jetë funksionale.

Në këtë rast thirret mbledhja e përgjithshme e jashëzakonshme dhe bëhet zgjedhja e anëtarëve të ri të kryesisë.(zgjidhet 1/3 e anëtarëve të ri).

Statuti i shoqates Rainca Version II

Mbledhja dhe Vendimet e Kryesisë

NENI 34

Kryesia e shoqatës mbledhet jo më pak se katër herë në vit.

NENI 35

Mbledhja e Kryesisë mundë të mbahet nëse të pranishëm janë minimalisht 2/3 e anëtarëve të saj.

Kryesia vendos me shumicë votash të anëtarëve që janë të pranishëm në mbledhje.

Në rast se kemi barazim votash, vendimmarrëse është vota e kryetarit.

NENI 36

Kryesia e shoqatës mund të marrë vendime edhe përmes emailit, skype-it, telefonit etj. Vendimet në këtë formë merren me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Kryesisë .

Në rast se kemi barazim votash, vendimmarrëse është vota e kryetarit.

NENI 37

Vendimet e Kryesisë protokollohen dhe nënshkruhen nga kryetari i shoqatës.

Statuti i shoqates Rainca Version II

Mbledhja dhe Vendimet e Kryesisë

NENI 38

Kryesia e shoqatës nuk guxon të marr vendime:

- a) nëse realizimi i vendimeve kalon mandatin e kryesisë;
- b) nëse projekti kalon 1/3 e shumës së të hyrave nga anëtarësia vjetore;

Për vendime të tilla vjen në shprehje NENI21 pika e).

NENI 39

Kryetari i Shoqatës përgatit materialin lidhur me rendin e ditës dhe e propozon atë thërret dhe drejton mbledhjet e Kryesisë, u jep fjalën anëtarëve të Kryesisë, drejton dhe moderon debatet, siguron rendin e mbledhjes dhe nënshkruan vendimet, të cilat i sjell kryesia;

NENI 40

Kryetari së paku një javë para mbajtjes së mbledhjes, duhet t'i njoftojë anëtarët e Kryesisë me pikat e rendit të ditës. Pikë rend dite mund të propozojë edhe çdo anëtar i Kryesisë.

Statuti i shoqates Rainca Version II

Mbledhja dhe Vendimet e Kryesisë

NENI 41

Sekretari mban procesverbalin, kujdeset për arkivin e shoqatës dhe kryen punë tjera administrative;

Më së largu një javë pas mbledhjes së Kryesisë , Sekretari duhet t'i informoj me shkrim anëtarët e Kryesisë për vendimet e mbledhjes paraprake.

NENI 42

Arkëtari mban dhe drejton financat dhe ka për detyrë që në çdo mbledhje t'i raportojë Kryesisë për buxhetin aktual të shoqatës.

Arkëtari mban një regjistër për anëtarësimet, e cila çdo muaj aktualizohet dhe publikohet në faqen e shoqatës në Facebook.

Statuti i shoqates Rainca Version II

Shqyrtimi dhe aprovimi I Kërkesave në Kryesi

NENI 43

Kërkesat merren parasysh dhe shqyrtohen vetëm atëherë kur paraqiten me shkrim dhe adresohen në adresën e shoqatës, apo në adresën e ndonjërit anëtarë të kryesisë së shoqatës.

Pa marrë parasysh natyrën e vendimit, Kryesia e shoqatës është e obliguar që parashtruesin e kërkesës ta lajmërojë me shkrim për vendimin e marrë.

Dokumenti, përveç simbolit të shoqatës dhe vules, për të qenë zyrtar, duhet të ketë edhe nënshkrimin e Kryetarit.

Ndarja e Mirënjohjeve

NENI 44

Për angazhimin e jashtëzakonshëm dhe arritjen e rezultateve në punën e shoqatës mund të ndahen: Lavdata, Mirënjohje, Dhurata, Nderime dhe Titul Nderi.

Kriteret për ndarjen e mirënjohjeve dhe dhuratave caktohen me vendim të veçantë nga Kryesia e Shoqatës.

Statuti i shoqates Rainca Version II

Këshili për Kontroll

NENI 45

- a) Këshilli për Kontroll është organ i shoqatës Rainca
- b) Këshilli për Kontroll zgjidhet nga kuvendi i shoqatës me mandat dy vjeçarë me mundësi zirgjedhje.
- c) Këshilli për Kontroll përbëhet nga tre Anëtarë.
- d) Këshilli për Kontroll zgjedh Kryesuesin.

NENI 46

KËSHILLI PËR KONTROLL ËSHTË KOMPETENT DHE KRYEN:

- a) kontrollën për zbatim të statutit dhe akteve të tjera,
- b) kontrollën për punën financiare dhe të tjera.
- c) për pikët a dhe b përgatit raportin dhe e parashtron për shqyrtim në kuvendin e shoqatës.

NENI 47

- a) Këshilli takohet sipas nevojës, por të paktën një herë në vit.
- b) Mbledhjet i thëret dhe i udhëheq kryetari i shoqatës.
- c) Këshilli për Kontroll punon ngusht me Kryesinë e shoqatës.

Statuti i shoqates Rainca Version II

Buxheti I Shoqatës Rainca

NENI 48

Buxheti i Shoqatës Rainca menaxhohet nga Kryesia e shoqatës Rainca.

Financimi (TË Hyrat e Shoqatës)

NENI 49

Burimet kryesore financiare të shoqatës janë:

- a) pagesa e anëtarësis
- b) të ardhurat nga aktivitetet e ndryshme të shoqatës
- c) sponsorët dhe donacionet e ndryshme;
- d) të ndryshme.

NENI 50

Anëtarët e Shoqatës Rainca duhet të paguajnë anëtarësinë vjetore.

Shuma minimale është 100,- CHF për anëtarët me banim në Zvicër.

Shuma minimale është 80,- € për anëtarët me banim jasht Zvicrës. (të konvertuara në CHF në kursin aktual)

Statuti i shoqates Rainca Version II

Shpenzimet(Të Dalurat e Shoqatës)

NENI 51

Shpenzimet e Shoqatës ndahën në dy kategori:

- a) Shpenzimet për financimin e aktiviteteve apo projekteve të parapara me vendimet e kryesisë.
- b) Shpenzimet administrative.

NENI 52

Shpenzimet që kategorizohen sipas NENI-t 51 pika a). mbulohen në tërësi nga Buxheti i Shoqatës Rainca.

NENI 53

Si Shpenzime Administrative hynë:

- (1) Shtypja e Dokumenteve,
- (2) Shpenzimet Postare,
- (3) Blerja e Mirënjohjeve, Ftesave, Dhuratave apo Dekorativave
- (4) Shpenzimet për organizimin e mbledhjes Gjenerale, dhe
- (5) Shpenzime tjera që mundë të dalin si rezultat i administrimit të shoqatës.

.

Statuti i shoqates Rainca Version II

Shpenzimet(Të Dalurat e Shoqatës)

NENI 54

Shpenzimet Administrative nuk guxojnë të kalojnë shumën 5% e “Të Hyrave Nga Anëtarësia Vjetore”. Mbi këtë shumë anëtarët e kryesisë së Shoqatës i bartin shpenzimet vet.

NENI 55

Të gjitha Shpenzimet (të dalurat) duhet të regjistrohen dhe të dokumentohen(faktohen),të nënshkruhen nga Kryetari i shoqatës Rainca dhe të ruhen në arkiv të shoqatës.

Statuti i shoqates Rainca Version II

Raporti Financiar

NENI 56

Kryesia e Shoqatës duhet të përpilojë në Mbledhjen Gjenerale (dymujorin e parë të vitit) Pasqyrën financiare vjetore dhe raportin vjetor për vitin paraardhës.
Pasqyra financiare vjetore duhet verifikuar nga Këshilli për Kontroll.

NENI 57

Pasqyra Financiare dhe Raporti vjetorë duhet:

- (1) të publikohet në faqen e shoqatës në Facebook,
- (2) të shtypet dhe të shpërndahet anëtarëve present në Mbledhjen Gjenerale dhe
- (3) të prezantohet me Poëer Point.

NENI 58

Valut e vetme zyrtare e shoqatës Rainca është Frangu Zvicëran (CHF). Në rastin e valutave tjera ato duhet të konvertohen në CHF me kursin aktual.

Statuti i shoqates Rainca Version II

DETYRIMET

NENI 59

Për Borxhet e Shoqatës detyrohet vetëm pasuria e Shoqatës. Personalisht anëtarët e Shoqatës janë të përjashtuara nga këto Detyrime.

NENI 60

Ky statut hyn në fuqi në ditën e miratimit në mbledhjen e kuvendit të shoqatës Rainca

Statuti i shoqates Rainca Version II

Votimi i Statutit te Shoqates Rainca Versioni II

**Datum : 19.03.2017,
Zvicer**

Falmnderit për Vemendjen

Shoqata Rainca

www.shoqata-rainca.ch

